



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 236, Datë 22.09.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “BINDI” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 170, DATË 26.10.2017**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, nenit 13, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/5 prot., datë 19.09.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “BINDI” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “BINDI” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 387, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 218, datë 01.09.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “BINDI” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 218/2022, i cili u publikua në datat 02.09.2022 dhe 03.09.2022. Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 16.09.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me shkresën nr. 1385/4 prot., datë 07.09.2022, ERE iu drejtua shoqërisë “BINDI” sh.p.k. me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1385/5 prot., datë 13.09.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Shoqëria “BINDI” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.
- Shoqëria “BINDI” sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 387, seria T17, të shoqërisë “BINDI” sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

